



NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS, Departamenti i Përgjithshëm, në kolegjin penal të përbërë nga gjyqtarët Shqipe Qerimi, kryetare e kolegjit, Afrim Shala dhe Beqir Kalludra, anëtarë të kolegjit, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtorit profesional Bujar Ahmeti, si procesmbajtës, në çështjen penale ndaj të pandehurit L.B. nga Gllgoc, për shkak të veprës penale lëndimi i lehtë trupor nga neni 185 paragrafi 1, nën-paragrafi 1.4. të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK), duke vendosur sipas ankesës së përfaqësuesit të të dëmtuarit B.K., avokatit Gazmend Halilaj, të datës 22 shtator 2020, të paraqitur kundër aktgjyimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë, Dega në Gllgoc, P.nr.189/2020, të datës 7 shtator 2020, në seancën e kolegjit të mbajtur më datën 19 janar 2021, mori këtë:

A K T G J Y K I M

REFUZOHET si e pabazuar ankesa e përfaqësuesit të palës së dëmtuar, avokatit Gazmend Halilaj, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë, Dega në Gllgoc, P.nr.189/2020, i datës 7 shtator 2020, VËRTETOHET.

A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Prishtinë, Dega në Gllgoc, me aktgjykimin e lartcekur, përkatësisht me aktgjykimin e ankimuar, të pandehurin L.B. e ka shpallur fajtor për shkak të veprës penale lëndimi i lehtë trupor nga neni 185 paragrafi 1, nën-paragrafi 1.4. të KPRK dhe ndaj tij për shkak të kësaj vepre penale është shqiptuar dënim me gjobë në shumën prej 300 € (treqind Euro), të cilin dënim është detyruar ta paguaj në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, nga dita kur ky aktgjykim të bëhet i formës së prerë. Nëse i pandehuri në afatin e caktuar nuk dëshiron apo nuk mund ta paguaj dënimin me gjobë,

gjykata do t'ia zëvendësoj në dënim me burgim, ashtu që 20 (njëzet Euro) e dënimit me gjobë do të jetë e barabartë me 1 (një) ditë burgim. Nëse i pandehuri në afatin e caktuar nuk dëshiron ose nuk mund të paguaj gjobën në tërësi, gjykata do t'ia zëvendësoj pjesën e mbetur të gjobë me dënim me burgim siç parashihet me nenin 43 paragrafi 3 të KPRK, e nëse personi i dënuar e paguan pjesën e mbetur të gjobës, ekzekutimi i dënimit ndërpritet.

Nëse i pandehuri nuk dëshiron ose nuk mund të paguaj gjobën, gjykata mundet me pëlqimin e të pandehurit në vend të shqiptimit të dënimit me burgim, t'ia zëvendësoj dënimin me gjobë me urdhër për punë në dobi të përgjithshme. Urdhri për punë në dobi të përgjithshme llogaritet ashtu që për çdo 8 (tetë) ore të punës me dobi të përgjithshme llogariten me 20 € (njëzet Euro) të dënimit me gjobë, dispozitë kjo e paraparë me nenin 43 paragrafi 5 të KPRK.

Është detyruar i pandehuri që në emër të shpenzimeve të procedurës penale të paguaj shumën prej 20 € (njëzet Euro), në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 30 € (tridhjetë Euro), si dhe për programin e kompensimit të viktimave të krimit shumën prej 30 € (tridhjetë Euro), të gjitha në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga dita kur ky aktgjykim të bëhet i formës së prerë, nën kërcënimin e përmbarimit me dhunë.

I dëmtuari B.G., për realizimin e kërkesës pasurore juridike është udhëzuar në kontest të rregullt civil.

Kundër këtij aktgjykimi në afatin ligjor ka paraqitur ankesë përfaqësuesi i të dëmtuarit, avokati Gazmend Halilaj, për shkak të shkeljes së ligjit penal dhe vendimit mbi dënimin, duke i propozuar Gjykatës së Apelit të Kosovës që ta prishë aktgjykimin e ankimuar, ndërsa të pandehurit t'i shqiptoj një dënim me burgim efektiv ose lëndën ta kthej në rigjykim dhe rivendosje.

Prokuroria e Apelit e Kosovës, me parashtresën PPA/II.nr.1039/2020, të datës 28 tetor 2020, ka propozuar që të aprovohet si e bazuar ankesa e përfaqësuesit të autorizuar të të dëmtuarit, ashtu që të ndryshohet aktgjykimin i ankimuar dhe ndaj të pandehurit të shqiptohet një dënim më i ashpër.

Në ankesën e mbrojtësit të të pandehurit, avokatit Gazmend Halilaj theksohet se dënimi i shqiptuar nuk përkon fare me peshën e veprës penale, mënyrën e kryerjes së saj, pasojat e shkaktuara nga ana e të pandehurit, veprimet e tij pas kryerjes së veprës penale, çka nënkupton se dënimi i shqiptuar nuk e arrin qëllimin siç parashihet me dispozitat ligjore. Në rastin konkret sikur të ishte bërë kualifikim i drejtë juridik i veprës penale për të cilën është shpallur fajtor i akuzuari, padyshim që nuk do të kishte shqiptuar këtë dënim kaq të butë, e aq më tepër sikurse të kishte ftuar në këtë seancë edhe të dëmtuarin që ta dëgjoj lidhur me ndodhjen e rastit dhe rrethanat tjera pas kryerjes së veprës penale nga ana e të akuzuarin, me të cilin asnjëherë nuk janë pajtuar, si dhe për shkak se edhe pas gjithë kësaj kohe i akuzuari nuk ka tentuar ta kompensoj të dëmtuarin, duke mos treguar

asnjë shenjë të keqardhjes apo të ndonjë veprimi me të cilin do të tregonte shenja të përmirësimit. Prandaj, përfaqësuesi i palës së dëmtuar konsideron që gjykata e shkallës së parë do të duhej të shqiptonte dënim me burgim efektiv, pa e përjashtuar dënimin plotësues me gjobë. Andaj, duke u bazuar në këto që u thanë më lart, përfaqësuesi i palës së dëmtuar, avokati Gazmend Halilaj i ka propozuar Gjykatës së Apelit të Kosovës si më lart.

Kolegji penal i Gjykatës së Apelit të Kosovës, pasi mbajti seancën e kolegjit, shqyrtoj shkresat e lëndës, vlerësoj pretendimet ankimore dhe analizoj aktgjykimin e ankimuar në kuptim të nenit 394 paragrafi 1 të Kodit të Procedurës Penale (KPP), konstatoj se :

- ankesa është e pabazuar.

Duke u bazuar në nenin 394 paragrafi 1 të KPP, kolegji penal i Gjykatës së Apelit të Kosovës, sipas detyrës zyrtare konstatoj se aktgjykimi i ankimuar nuk përmban shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale dhe as shkelje të ligjit penal në dëm të të pandehurit.

Sipas vlerësimit të kolegjit penal të Gjykatës së Apelit të Kosovës, pretendimet ankimore të paraqitura në ankesën e përfaqësuesit të të dëmtuarit janë të pabazuara. Kolegji penal i Gjykatës së Apelit të Kosovës vlerëson se gjykata e shkallës së parë drejtë i ka konstatuar dhe vlerësuar rrethanat të cilat ndikojnë në caktimin e llojit dhe lartësisë së dënimit. Kështu, gjykata e shkallës së parë me rastin e matjes së dënimit ndaj të pandehurit L.B., kishte marrë për bazë si rrethana lehtësuese pranimin e fajësisë, se nuk ka të dhëna se ndaj tij zhvillohet procedurë tjetër penale, se i ka premtuar gjykatës se në të ardhmen nuk do të përsërisë vepra të tilla apo tjera penale, se është i pënduar për kryerjen e kësaj vepre penale, ka kërkuar falje, si dhe faktit se është i martuar. Ndërsa, si rrethana rënduese gjeti faktin se në rastin konkret kemi shkallë të lartë të dashjes nga ana e të pandehurit gjatë kryerjes së veprës penale. Duke i pasur parasysh të gjitha rrethanat të cilat i ka konstatuar dhe vlerësuar edhe gjykata e shkallës së parë dhe rrethanat tjera të rastit konkret, kolegji penal i Gjykatës së Apelit të Kosovës vlerëson se dënimi i shqiptuar ndaj të pandehurit L.B., nga ana e gjykatës së shkallës së parë është dënim i drejtë, i ligjshëm, në harmoni me mënyrën e kryerjes së veprës penale, me peshën e veprës penale, me sjelljet të pandehurit para dhe pas kryerjes së veprës penale, me gjendjen ekonomike të tij, si dhe me shkallën e përgjegjësisë penale. Gjithashtu, kolegji penal i Gjykatës së Apelit të Kosovës është i bindur se me këtë dënim do të arrihet qëllimi i dënimit i parashikuar me nenin 38 të KPRK, i cili konsiston në parandalimin e të pandehurit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e tij; të parandalojë personat e tjerë nga kryerja e veprave penale; të bëjë kompensimin e viktimave ose të komunitetit për humbjet ose dëmet e shkaktuara nga vepra penale dhe të shprehë gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit. Andaj, edhe disa nga rrethanat të cilat përmenden në ankesën e përfaqësuesit të palës së dëmtuar, e të cilat nuk janë vlerësuar nga ana e

gjykatës së shkallës së parë nuk konsiderohen rrethana të cilat do të justifikonin shqiptimin e ndonjë dënimi më të ashpër, duke i pasur parasysh rrethanat që u paraqitën më lart.

Andaj, duke u bazuar në këto që u thanë më lart e në bazë të nenit 401 të KPP, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS
Departamenti i Përgjithshëm
PA1.nr.1026/2020, më datën 19 nëntor 2021

Bashkëpunëtori profesional,
Bujar Ahmeti

Anëtarët e kolegjit:
Afrim Shala

Kryetare e kolegjit,
Shqipe Qerimi

Beqir Kalludra
